Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit _Toc72826939

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
(Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	<i>7</i>	<i>8</i>
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	Emri dhe Vendi i origjines se mallit/prodhuesit	Afati i levrimit te mallit
1.						
2.						
3.						
4						
	Çmimi total (Mallrat)				_____	
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						

Vula		
Datë _____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Loti nr. 1 - Blerje paisje mjekësore për kirurgjinë e avancuar laparoskopike në SUT

I. Kolon Laparoskopike

1. Karrocë qendrore endoskopie duhet të ketë:
 - Transformator të izoluar
 - Minimalisht 5 rafte, me gjerësi 500 mm
 - Një raft rëshqites me dorezë
 - Një sirtar
 - Mbajtës i integruar i kokës së kamerës dhe mbështjellës kabllor
 - 10 kablllo energjie me lidhje ekuipotenciale për njësitë
 - Mbajtëse për bombol CO2 30-50L
 - Kablllo rryme me gjatësi ekuipotenciale lidhëse 5m
 - Rrota antistatike te paisura me mbrojtëse kablllosh. Diametri 125 mm
 - Kapaciteti i ngarkesës 180 kg, për raft 30 kg
 - Kapaciteti i ngarkesës së raftit të zgjatshëm 20 kg
 - Mbajtëse për kabllon DP me kablllo zgjatuese DP M/F (nga Ccu në mbajtëse)
 - Mbajtëse për shishe CO2 30-50L
2. Krahu mbajtes i Monitorit te jete i artikulueshem me te pakten nje nyje per mbajtje te monitorit 32", nyja të qendrojë në aksin (në qender) të paisjes
3. Mbajtes i shishes CO2
4. Kablllo ushqyese
5. Krahu per mbajtjen e tabletës, duhet te jete i pozicionuar në raftin e sipërm të karrocës
6. Monitor Mjekesore 4K:
 - Paneli 31,5-32": TFT LCD / ndriçim LED
 - Skanim progresiv. Teknologji 10 bit me mundësi për të treguar më shumë se 1.000.000.000 ngjyra
 - LCD rezolucion: 4K (3840 x 2160), 16:9
 - Paisja te ofroje mundesine vendosjes se nje figure te dyte me te vogel mbi figuren ne ekran njekohesisht (picture in picture). Paisja te mundesoje ndarjen e ekranit per vendosjen e dy pamjeve njeheresh, (Picture and Picture)
 - Hyrja e videos: DP 1.2, 1 x DVI-HD, 1 x DVI optike, 1 x 3G-SDI-HD, Dalja e videos: 3G-SDI
7. Mbulesa mbrojtëse për monitorin 31.5".
8. Konsolë qendrore 4K - njësi qendrore 4K sistem video/kamera + sistem për perpunimin e sekuencave video dhe fotografimeve, te administrueshme nga tableti qe kontrollon systemin.
 - Kontroll Qendror 4K i Sistemit të Videos, Përfshirë Burimin e Dritës dhe Kontrollin e Kamerës dhe Përbunimin e Fototve dhe Videove.
 - Memorie e brendshme minimale 120 GB, rezolucion i fotove të ruajtura: min 3840 x 2160 pixel.
 - Fotografitë te ruhen si JPG
 - Videot qe ruhen te kene rezolucion 1080p ose më shumë, lloji i videos MP4
 - Konsola te mundësoje eksportin të dhenave ne te gjitha mundesite si ne vijim: USB, Network drive, iPad, PACS nëpërmjet DICOM, e-mail. Të dhënat mund të eksportohen automatikisht ose sipas kërkesës
 - Te kete te instaluar driverin e printerit, akses PiP dhe gjenerim automatik te raporteve PDF për çdo procedure
 - Të gjitha funksionet ekolones endoskopike te jene te kontrolluara nga tablet me madhësi minimale 10".

- Burimi i dritës LED min. 1600 Lumen, 5500-8500 K, me garanci 30.000 orë pune dhe e integruar në njësinë qendrore
 - Fuqia është e barabartë me Xenon 300W
 - Sistem ekspozimi (fenestrim i vogël) për sinkronizimin e informacionit për 4 llojeve të ndryshme të dritës.
 - Sistemi për Përpunimin e Fotove dhe Videove
 - Të mundesojë për live streaming (të mundesosh akses të drejtpërdrejtë të procedurave për persona të tretë që janë jo prezent fizikisht në spital.
 - Shikim i drejtpërdrejt i procedurave nga vende të largëta përmes WEB VIEW, komunikim i dyanshëm
 - Pajisja të ofrojë personalizim të setimeve të saj për çdo kirurg
 - Daljet video të jete: 2 x DVI (HD 1080p), 4 x 3G-SDI (HD 1080p), 2 x Porta për ekran 4K
 - Hyrja video: 1 x DVI (HD 1080p)
 - Kulla të ofrojë akses DICOM (me licence të perjetshme) për dokumentim dhe lidhjen e saj në sistem, të aksesueshëm nepermjet rrjetit Ethernet dhe WIFI
 - Pajisja të ketë minimalisht 6 dalje USB
 - Hyrje audio për mikrofonin
 - Parametrat e endoskopit të jete të ekspozuar në monitor gjatë punës
 - Mundësia e lidhjes së kokave të kamerës fluoreshente me 1 çip, 3 dhe 4 çipa
 - Pajisja të ketë të përfshira të gjitha kabllot e lidhjes për njësitë të përfshihen në të (një set kabllor)
9. Kablllo BNC 3m, 75OHM
10. Kabell për portën e ekranit 3m
11. Tablete për dokumentim dhe komtrroll funksionesh
- Të jete me madhësi minimale 10 inch
 - Të ofrojë mundësi të monifikimit të parametrave të para vendosur në njësinë qendrore
 - Të shërbejë për menaxhimin e imazheve dhe videove të marra në procedurë kirurgjikale
12. Mbulesa mbrojtëse për tabletin 10"
13. Koke kamera 4K
- 3 çip, koka e kamerës 4K
 - Rezolucion: 3840 x 2160 pixels
 - Skanim progresiv. Teknologji 10 bit me mundësi për të treguar më shumë se 1.000.000.000 ngjyra.
 - Zmadhimi: 1.5X, mundësia e programimit të 4 funksioneve të butonave të kokës së kamerës.
 - Të jete plotësisht e autoklavueshme me 3 vjet garanci për procesin e autoklavimit.
 - Të jete prej materiali titan
14. Laparoscope 30°, 4K 10 mm x 330 mm
15. Burimi i dritës
- Të tejdukshme
 - 5 mm x 274 cm
16. Insuflator, prurje minimale 50 L, ngrohje me gaz
- Ekran me prekje
 - Dy mënyra, rrjedhje e lartë dhe bariatrike
 - Të gjithë parametrat janë të dukshëm në monitorët kirurgjikal
17. Konektor ISO i grupit të tubave, i ripërdorshëm 20x, i autoklavueshëm
18. Set tubash me ngrohje, të ripërdorshëm 100x, i autoklavueshëm
19. Reduktor presioni për konvertimin e presionit nga burimi në insuflator / shishe DIN 1.5 m për insuflator
- ❖ **Pajisjet duhet të jenë sipas standarteve CE ose ekuivalent.**

❖ **Për paisjet mjekësore, OE duhet të jetë i autorizuar nga MSHMS për tregëtimin e pisjeve mjekësore.**

Loti nr. 2 – Blerje shtrat operator për SUT

II. Shtrat Operator

- Tavolina perbehet nga 5 segmente Koka, Shpatullat, Ndenjesja dhe segment te ndare per secilen kembe
- Komandimi behet si nga telekomanda dhe nga paneli ne kolonen e Shtratit
- Pjesa e dyshekut eshte e perbere me tre shtresa per nje rehati maksimale te pacientit
- Pjesa e kurrizit dhe lartesia e tavolines operatore jane te rregullueshme.
- Tavolina eshte radiolucente ndaj rrezeve X
- Shtrati eshte i pajisur me shina anesore per vendosjen e aksesoreve
- Permasat e shtratit te tavolines pa perfshire shinat anesore te pakten: 220 cm x 56 cm
- Trendelenburg / Reverse Trendelenburg elektrikisht te rregullueshme -30°/ 30°
- Lartesia eshte e rregullueshme ne menyre elektrike: 595-1035mm
- Pjesa e kokes (larte/poshte) e rregullueshme ne diapazonin : 30°/-90°
- Perkulje anesore (majtas/djathtas) e rregullueshme ne diapazonin 20°/-20°
- Pjesa e shpines (lart/poshte) ne diapazonin 80°/-45°
- Pjesa e kembeve ne diapazonin 30°/-80°
- Pjesa e kembeve e ndare ne 2 seksione
- Trashesia e dyshekut min 70 mm

Aksesorë shoqërues:

- Çizme për pozicionimin e këmbëve
- Sistemi i pozicionimit me kontroll me një dorë dhe vetë-frenim
- Mbështetese e krahut, përfshirë kapësen dhe rripin e fiksimit
- Lartësi e rregullueshme
- Ekran per anestezi , perfshirë kapësen e fiksimit, celik inoks .
- Rrip për fiksimin e trupit Gjatesi deri ne 230 cm ,gjatesi e rregullueshme ,
- Suport shpatullash, Çift -Përfshirë kapëset e fiksimit
- Lartësi e rregullueshme, celik inoks.
- Mbështetje anësore, Çift-Përfshirë kapëset e fiksimit,e rregullueshme
- E rrotullueshme dhe me tilt
- Lartësia e rregullueshme- celik inoks .
- Set për proktologji
- Set rrotullash rektoskopike dhe mbështetëse gjuri
- Përfshirë kapëset e fiksimit
- Mbështetje gjuri e rrotullueshme dhe e përkulshme
- Rrotull rektoskopi i rregullueshëm në lartësi dhe kënd, celik inoks .
- Mbështetese për kokën dhe kyçin
- Mbështetje e kokës e rrotullueshme dhe e përkulshme dhe mbështetëse e kyçit të dorës
- Lartësia dhe këndi i rregullueshëm
- Wilson Frame Set- 1 copë jastëk i madh mbeshtetes
- Mbeshtetese koke (patkua) xheli per adulte
- Bllokues kembesh/mbeshtetes gjuri (1 pale),
- Mbeshtetes shpatulle (1 pale),
- Irrigator (1 cope).

❖ **Paisjet duhet të jenë sipas standarteve CE ose ekuivalent.**

❖ **Për paisjet mjekësore, OE duhet të jetë i autorizuar nga MSHMS për tregëtimin e pisjeve mjekësore.**

Loti nr. 3 - Blerje aparate EKG për shërbimet mjekësore në SUT

Elektrokardiogramë me 12 kanale e cila duhet të jetë portative me ushqim AC 100V deri 240 V 50/60HZ, për përdorim spitalor. Të jetë me bateri të integruara dhe të mbajë bateri minimumi 1(një) orë duke bërë ekzaminime. Mënyra e funksionimit të jetë dhe automatike dhe manuale. Të arrijë frekuencat 0.05Hz deri në 150 Hz. Të jetë me sensitivitet 2.5, 5, 10, 20, 10/5, AGC(mm/mV). Shpejtësia e regjistrimit të jetë 5, 6.25, 10, 12, 25, 50 mm/s. Printimi i letrës të jetë termik. Të ketë mundësi lidhje me PC për të transferuar të dhënat. Të ketë portë USB për lidhje me printer të jashtëm. Të ketë suport dhe për skanim të barkodeve të ndryshme. Memoria e brendshme të ketë mundësi zgjerimi me USB ose SD card dhe të arrijë të regjistrojë minimumi 200 ekzaminime.

Gjtashtu OE i cili do realizojë furnizimin me EKG në SUT duhet të sjellë fisha rezervë për cdo EKG që do sjellë. Të mbajë garanci minimumi 1(një) vit nga data e furnizimit. Aparatet të jenë me certifikatë CE. Nevojat për EKG janë shërbimet mjekësore në SUT, gjithsej 9 copë.

- ❖ **Paisjet duhet të jenë sipas standarteve CE ose ekuivalent.**
- ❖ **Për paisjet mjekësore, OE duhet të jetë i autorizuar nga MSHMS për tregëtimin e pisjeve mjekësore.**

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas tabelës si me poshtë:

Nr. / Loti	Emertimi	Njësia	sasia
1	Blerje paisje mjekësore për kirurgjinë e avancuar laparoskopike në SUT	cope	1
2	Blerje shtrat operator për SUT	cope	1
3	Blerje aparate EKG për shërbimet mjekësore në SUT	cope	9

Loti nr. 1 - Blerje paisje mjekësore për kirurgjinë e avancuar laparoskopike në SUT

Kohëzgjatja në muaj 01 ose ditë 31 duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës

Loti nr. 2 – Blerje shtrat operator për SUT

Kohëzgjatja në muaj □□ ose ditë 7 duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës

Loti nr. 3 - Blerje aparate EKG për shërbimet mjekësore në SUT

Kohëzgjatja në muaj □□ ose ditë 7 duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përtjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2019-2020-2021). Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë duhet të jetë në masën 20% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.1 dhe pika 2.2 do të jenë të njëjtat për të treja lotet.

Kriteret e vecanta ”Kapaciteti teknik” do të jenë të ndara sipas loteve si më poshtë:

Loti nr. 1 - Blerje paisje mjekësore për kirurgjinë e avancuar laparoskopike në SUT

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 20% të vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojes së

mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Auto-deklarate për origjinën e mallit, ku të përcaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese (të plotësohet dhe në shtojcën 1 – oferta ekonomike).

2.3.3 OE duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë paisjet objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë Certifikatën konformiteti CE, FDA ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregtim të paisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotografi dhe katalogë teknikë të produkteve

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti nr. 2 – Blerje shtrat operator për SUT

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 20% të vlerës së fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Auto-deklarate per origjinen e mallit, ku te percaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese (te plotesohet dhe ne shtojcen 1 – oferta ekonomike).

2.3.3 OE duhet të paraqesi autorizim nga prodhuesi ose distributor I autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë paisjet për këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE, FDA ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuara.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotografi dhe katalogë teknikë të produkteve

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti nr. 3 - Blerje aparate EKG për shërbimet mjekësore në SUT

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 20% të vlerës së fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Auto-deklarate per origjinen e mallit, ku te percaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese (te plotesohet dhe ne shtojcen 1 – oferta ekonomike).

2.3.3 OE duhet të paraqesi autorizim nga prodhuesi ose distributor I autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë paisjet për këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE, FDA ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuara.

2.5. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotografi dhe katalogë teknikë të produkteve

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

<p>ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1	_____

të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose	Po [] Jo []

